



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

Qershor 2024

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

QERSHOR 2024

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen aktivitetet e ZKPSH-së për muajin QERSHOR 2024

U.D. Kryeprokurori i Shtetit: Uebportali i ri afroh sistemin prokurorial me publikun, median dhe shoqërinë civile

Prishtinë, 05 Qershor 2024 –

Në ceremoninë e lansimit të uebportalit të ri të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur një fjalë rasti, ku ka theksuar se kjo dritare e informacionit që po lansohet sot do të jetë një mënyrë e mirë që secili qytetar, organizatë e shoqërisë civile apo media të ketë informacione me të plota dhe në kohë reale, në mënyrë që imazhi i Prokurorit të Shtetit dhe sistemit prokurorial të avancohet, siç është duke u avancuar çdo ditë dhe për këtë ka falënderuar shoqërinë civile dhe mediat, të cilat po ndikojnë që të rritet besimi i publikut në punën e Prokurorit të Shtetit.



Gjithashtu U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka inkurajuar qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile që t'i shfrytëzojnë mundësitë dhe qasjen që sistemi prokurorial po ju jep atyre, siç është kjo e ueb portalit të ri ku do të mund të kenë informacione më të shumta për punën që e bënë Prokurori i Shtetit, sepse është duke u bërë punë e madhe.

Në fund, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka falënderuar UNDP-në e cila ka mbështetur këtë projekt.

Dizajnimi dhe zhvillimi i uebportalit të ri të sistemit prokurorial është mundësuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, konkretisht nga Projekti "Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit, SAEK III, përmes ndihmës së Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së

Suedisë dhe do të jetë në shërbim të mediave, të shoqërisë civile dhe të të gjithë qytetarëve të vendit.

Përfaqësuesit e sistemit prokurorial marrin pjesë në publikimin e Raportit të OSBE-së për vlerësimin e efektivitetit të reagimit gjyqësor ndaj krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”

Prishtinë, 5 qershor 2024 –

Zëvendëskryeprokurori i Shtetit, z. Agron Qalaj dhe anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë së Apelit, z. Arian Gashi morën pjesë në prezantimin e Raportit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), me titull: “Nga letra në praktikë – vlerësimi i efektivitetit të reagimit gjyqësor ndaj krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”.



Që të dy ishin në cilësinë e panelistëve, me ç'rast janë përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve.

Në këtë publikim ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë së vendit, me ç'rast u diskutuan gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raportit, i cili ka për qëllim t'i ndihmojë institucionet relevante në adresimin e mangësive të identifikuara në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmes ofrimit të rekomandimeve praktike të bazuara në gjetjet nga monitorimi i proceseve gjyqësore nga ana e projektit.



Në përmbyllje të takimit të sotëm u tha se është thelbësor bashkëpunimi i sistemit të drejtësisë dhe organizatave ndërkombëtare siç është OSBE-ja, për adresimin e sfidave dhe përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit në sistemi prokurorial dhe gjyqësor.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pjesë e Forumit Konsultativ të kryeprokurorëve të përgjithshëm dhe kryeprokurorëve special të Ballkanit Perëndimor

Prishtinë, 7 Qershor 2024 –

Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi së bashku me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), z. Blerim Isufaj dhe prokuroren e PSRK-së, znj. Ilirjana Çollaku - Tafa, kanë marrë pjesë në Forumin Konsultativ të kryeprokurorëve të përgjithshëm dhe kryeprokurorëve special të Ballkanit Perëndimor që është mbajtur në Budva të Malit të Zi, takim ky që është organizuar nga Zyra e Prokurorit Suprem të Shtetit të Malit të Zi dhe EUROJUST përmes Projektit të Drejtësisë Penale për Ballkanin Perëndimor.



Takimi filloj me një fjalë mirëseardhjeje të nikoqirëve të kësaj ngjarjeje, përkatësisht Kryeprokurorit Suprem të Shtetit të Malit të Zi, z. Milorad Markovic, Presidentit të EUROJUST-it, z. Ladislav Hamran, për të vazhduar me kryeprokurorët e përgjithshëm dhe kryeprokurorët special të të gjitha të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë fjalës se tij, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka vlerësuar lartë këtë takim si një mundësi të mirë për të rritur bashkëpunimin në mes të prokurorive të vendeve të rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve tjera ndërkufitare, me ç'rast ka potencuar se pjesëmarrja e delegacionit të Prokurorit të Shtetit në këtë takim tregon gatishmërinë dhe vullnetin institucional për bashkëpunim me gjitha prokuroritë e Ballkanit Perëndimor.



Po ashtu, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka folur edhe për rëndësinë që Prokurori i Shtetit i ka dhënë bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në fushën penale, rëndësinë e shkëmbimit të përvojave të ndërsjella institucionale dhe mundësitë që i japin Prokurorit të Shtetit mekanizmat dhe instrumente e EUROJUST-it në fushën e drejtësisë penale.

Në anën tjetër, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj, gjithashtu foli për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar mes shteteve të rajonit dhe të BE-së për të luftuar aktivitetet kriminale ndërkufitare në mënyrë sa më të suksesshme.

Ai ka theksuar se përmes ndihmës së ofruar nga EUROJUST, Prokuroria Speciale e Kosovës ka

treguar rezultate më të kënaqshme në luftimin e krimit të organizuar.

Kryeprokurori Isufaj potencoi faktin se ky bashkëpunim mes Kosovës dhe Projektit të EUROJUST-it për Drejtësinë Penale për vendet e Ballkanit Perëndimor ka mundësuar që edhe Republika e Kosovës tashmë të jetë pjesë e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore që themelohen mes shteteve me asistimin e EUROJUST për hetimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe krimeve tjera ndërkufitare.

Ky takim i nivelit të kryeprokurorëve të përgjithshëm dhe kryeprokurorëve special të rajonit ka pasur për synim të nxisë dhe përmirësojë bashkëpunimin juridik ndërkufitar dhe sfidat në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale takohen me Presidentin e EUROJUST-it

Prishtinë, 07 Qershor 2024 –

Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, së bashku me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), z. Blerim Isufaj, dhe Prokuroren e PSRK-së, znj. Ilirjana Çollaku – Tafa, kanë zhvilluar takim me Presidentin e EUROJUST-it, z. Ladislav Hamran.



Temë qendrore e takimit ndërmjet përfaqësuesve të institucionit të Prokurorit të Shtetit me Presidentin Hamran ishte avancimi i bashkëpunimit dypalësh, konkretisht nevoja e pranisë së Kosovës si vëzhguese e përhershme në EUROJUST, që u

vlerësua si hap esencial për forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Në këtë kontekst, Presidenti i EUROJUST-it ka vlerësuar lartë angazhimin, bashkëpunimin dhe ndërveprimin e ngushtë që prokurorët kosovarë kanë pasur dhe vazhdojnë ta kenë me këtë agjenci të BE-së në fushën e drejtësisë penale.



Në anën tjetër, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka falënderuar Presidentin Hamran për bashkëpunimin konstruktiv dhe ndihëm profesionale që EUROJUST e ka dhënë për Prokurorin e Shtetit, duke theksuar se duhet të jemi të vendosur në luftimin e të gjitha formave të krimit, me ç'rast ka shprehur gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet në të ardhmen.

Ndërkaq, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, z. Blerim Isufaj, ka folur për veprimet që PSRK i ka ndërmarrë në intensifikimin dhe avancimin e bashkëpunimit me EUROJUST-in, si dhe ka potencuar se PSRK do t'i përgjigjet në kohë dhe në mënyrë efektive të gjitha kërkesave dhe obligimeve që adresohen nga EUROJUST-i.



Në nëntor të vitit 2022, institucioni i Prokurorit të Shtetit ka zyrtarizuar bashkëpunimin juridik me

EUROJUST, duke caktuar prokurorin ndërlidhës të përhershëm si dhe një prokuror si pikë kontakti lidhur me implementimin e projektit "WB CRIM JUST", i cili ka filluar të zbatohet në Ballkanin Perëndimor.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale takohen me Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë, Kreun e SPAK-ut dhe Kryeprokurorin Suprem të Malit të Zi

Prishtinë, 8 Qershor 2024 –

Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi së bashku me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), z. Blerim Isufaj, dhe prokuroren e PSRK-së, znj. Ilirjana Çollaku - Tafa, gjatë Forumit Konsultativ të kryeprokurorëve të përgjithshëm dhe kryeprokurorëve specialë të Ballkanit Perëndimor që është mbajtur në Budva të Malit të Zi, kanë zhvilluar takime me Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë, z. Olsian Çela, Kreun e SPAK-ut, z. Altin Dumani, dhe Kryeprokurorin Suprem të Shtetit të Malit të Zi, z. Milorad Markovic.



Gjatë takimit me homologët e shtetit shqiptar - Prokurorin e Përgjithshëm, z. Çela dhe Kreun e SPAK-ut, z. Dumani, U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale i Republikës së Kosovës, patën diskutime të frytshme për tema të punës së përbashkët, përkatësisht ngritjen e nivelit të bashkëpunimit,

koordinimit dhe efikasitetit në luftën kundër krimin dhe forcimin e sundimit të ligjit në të dyja shtetet.



Po ashtu, U.D. Kryeprokurori Kelmendi dhe Kryeprokurori Isufaj, janë takuar edhe me Kryeprokurorin Suprem të Shtetit të Malit të Zi, z. Milorad Markovic, me të cilin kanë diskutuar për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të memorandumeve si dhe për formimin e ekipeve të përbashkëta të hetimit me qëllim të luftimit të të gjitha formave të krimin.

Zyra për Rikthimin e Aseteve po mbanë punëtori për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit

Prishtinë, 12 Qershor 2024 –

Zyra për Rikthimin e Aseteve, nën udhëheqjen e prokurorit të shtetit z. Bahri Hyseni, po mbanë në Ohër punëtorinë për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Zyrën për Rikthimin e Aseteve.



Në këtë punëtori po merr pjesë edhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi, partnerët ndërkombëtar, të cilët e mbështesin punën e kësaj Zyreje nga projekti

ROLAG, prokurorë të shtetit, si dhe zyrtarë të deleguar të institucioneve ligj zbatuese.



Këto procedura standarde të veprimit, të cilat po hartohen në përputhje me dokumentet dhe standardet e BE-së për rikthimin e asetëve do të jenë ndihmesë për të gjithë prokurorët që kanë nevojë për ndihmën e Zyrës për Rikthim të Asetëve.

Urimi i Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me rastin e Festës së Kurban Bajramit

Prishtinë, 16 Qershor 2024 -

Të nderuar besimtar mysliman që kremtoni festën e Kurban Bajramit me lejoni që t'iu përcjellë urimet më të ngrohta dhe të përzemërta për Ju dhe familjet tuaja!

Festat si kjo përçojnë mesazhe dhe ndjenja pozitive tek të gjithë. Prandaj, në frymën e kësaj, uroj që në shtëpitë dhe familjet tuaja të mbizotëroj gëzimi, shpresa dhe mirësia!



Me respekt,

Besim Kelmendi

U.D. Kryeprokuror i Shtetit

Përfaqësuesit e institucioneve prokuroriale, gjyqësore dhe të Akademisë së Drejtësisë të Kosovës takohen me Sekretarin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë së Gjermanisë

Prishtinë, 20 qershor 2024 –

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj, dhe Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, u takuan sot, me Sekretarin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë së Federatës Gjermane, Benjamin Strasser.

Në takim morën pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Fondacionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), Stefan Hülshörster, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë së Federatës Gjermane, Piotr Maladionski, dhe përfaqësuesi i Ambasadës së Federatës Gjermane në Kosovë, Sebastian Leuschner, me bashkëpunëtorët e tyre.



Gjatë këtij takimi janë diskutuar objektivat dhe prioritetet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, me fokus në reformën në drejtësi, sundimin e ligjit dhe fuqizimin e profesioneve të lira.

Përfaqësuesit e institucioneve kosovare shprehën mirënjohjen e tyre për mbështetjen e vazhdueshme të Federatës Gjermane dhe veçanërisht të IRZ-së në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Sekretari Strasser falënderoi institucionet kosovare për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon angazhim proaktiv të kryeprokurorëve në shqyrtimin e detyrueshëm të hetimeve

Prishtinë, 25 Qershor 2024 –

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjin e rregullt me të gjithë kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive të vendit, në të cilin kanë marrë pjesë edhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe përfaqësuesja e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, znj. Edita Kryeziu.



Në këtë takim, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka diskutuar me kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive për unifikimin e praktikave lidhur me autorizimet e Prokurorit të Shtetit për Policinë, si dhe për veprimet procedurale të cilat i ndërmarrin prokurorët para dhe gjatë hetimeve, ku në këtë drejtim, U.D. Kryeprokurori i Shtetit z. Besim Kelmendi informoi kryeprokurorët se do të nxjerr Udhëzime të Detyrueshëm për të gjithë prokurorët e shtetit lidhur me këtë çështje.

Një temë tjetër me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe nevoja për caktimin e prokurorëve përgjegjës në secilën prokurori për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale, si dhe përfaqësimi i institucionit të

Prokurorit të Shtetit në aktivitetet zyrtare brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka kërkuar nga kryeprokurorët e prokurorive që të angazhohen maksimalisht në rritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale dhe të kenë një rol më proaktivë në shqyrtimin e detyrueshëm të hetimeve për çdo tre (3) muaj, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit po merr pjesë në punëtorinë për prezantimin e perspektivës reformuese të sistemit prokurorial

Prishtinë, 27 qershor 2024 –

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) në bashkëpunim me OSBE-në në Kosovë, organizoi një punëtori dyditore në Tiranë, në të cilën morën pjesë Kryesuesi i Këshilli Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, anëtarë të KPK-së, prokurorë të ZKPSH-së, kryeprokurorë, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Drejtoresha e NJSHPP-së, përfaqësues të OSBE-së dhe zyrtarë të administratës së sistemit prokurorial.



Qëllimi i mbajtjes së kësaj punëtorie ishte prezantimi i perspektivës së sistemit prokurorial, sidomos me fokus të veçantë në realizmin e barazisë gjinore dhe integrimin e komuniteteve.

Në sesionin e ditës së parë folën Kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi dhe

përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Mark Lasser, të cilët theksuan rolin dhe rëndësinë e madhe të zbatimit të barazisë gjinore dhe integritit të pjesëtarëve të komuniteteve në sistemin e drejtësisë. “Jemi të vetëdijshëm që me një angazhim të përbashkët në sistemin e drejtësisë mund të arrijmë rezultate të qëndrueshme në kuadër të arritjes së barazisë gjinore dhe integritit të pjesëtarëve të komuniteteve në Kosovë”, tha më këtë rast Kryesuesi Hajdaraj.



Po ashtu në këtë punëtori pati diskutime edhe për sfidat e integritit të të rinjve nga radhët e komuniteteve, si dhe për përdorimin e gjuhëve dhe sfidat e përkthimit në seancat gjyqësore, me ç'rast pjesëmarrësit u pajtuan që të ketë intensifikim të angazhimeve të përbashkëta për këto çështje që u diskutuan për dy ditë me radhë, sepse është nevojë e kohës që të ketë progres të mëtejshëm në rrugën përpara.